



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.72

Prishtinë, më 5.12.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi
Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik

Mungoi Sërgjan Popoviq, Shukrije Bytyqi

Përfaqësues të ftuar: Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji.

Përfaqësues të tjerë: Mediat, përfaqësues të OSBE

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 29.11.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-090 për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;**
- 4. Shqyrtimi i projekt buxhetit për 2017 për MASHT, MKRS dhe Ministrinë e Diasporës;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i Procesverbalit të datës: 29.11.2016;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më datë 29.11.2016 u miratua, por pati një sugjerim të Ismajl Kurteshit që diskutimet gjatë mbledhjeve të Komisionit të paraqitën më gjerësisht.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-090 për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;

Nait Hasani, tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka pasur vërejtje për Projektligjin në fjalë, ndërsa Komisioni për Integritet Evropian, ai për Legjislacion si dhe ai për komunitete nuk kanë pasur vërejtje në lidhje me projektligjin për sponsorizime dhe donacione.

Ai shtoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk është pajtuar më formën e paraqitur rreth përqindjes së sponsorizimit, dhe propozoi që projektligji me amendamentet e propozuara të Komisionit funksional të procedohet për lexim të dytë.

Salih Morina tha se në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa Ministri i Financave dha arsyetimin që përqindja e propozuar pamundëson implementimin në praktikë të këtij ligji. Ai tha se Komisioni për Buxhet ka sugjeruar që ligji fillimisht të zbatohet sipas përqindjeve të propozuara nga Ministria e Financave. Ne si anëtar të komisionit mund ta procedojmë projektligjin për Kuvend me këtë përmbajtje, por duhet të dimë se si ta argumentojmë si Komision dhe si ta mbrojmë atë, pasi që mund të ballafaqohemi me Ministrin e Financave dhe atë të MKRS sepse ligji mund të jetë i pazbatueshëm me këto përqindje.

Nait Hasani tha se forma më e mirë për realizimin e nevojave të sportit është përmes sponsorizimit dhe nëse nuk u krijojmë kushte të favorshme sponsorizuesve të huaj, atëherë nevojat e sportit nuk do të realizohen, pasi që bizneset tona nuk kanë mundësi për investime të mëdha.

Ismajl Kurteshi tha se bazë mbi të cilën duhet të merret vendimi është gjendja ekonomike në Kosovë dhe se nuk është për miratimin e ligjeve të cilat do të mbeteshin të pazbatueshme. Ai shtoi se mbështet përpjekjet që sporti të zhvillohet krahas fushave të tjera dhe se ndërmarrjet që sponsorizojnë sportin, në rradhë të parë investojnë në Kosovë dhe një pjesë e tatimit në vend që të shkojë në Buxhet të Kosovës, shkon si sponsorizim. Në fund të diskutimit të tij tha se duke marrë parasysh të gjitha këto, do të abstenojë për votim të tij.

Anëtarët e Komisionit e proceduan për lexim të dytë në seancë plenare Projektligjin nr.05/L-090 për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me amendamentet e propozuara ndërsa rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa që i referohet

amendamentit 17 nuk mori përkrahje nga anëtarët e Komisionit dhe i njëjti u propozuar që të radhitet si propozim i Komisionit për Buxhet në raportin me rekomandime për lexim të dytë. Për amendamentet e propozuara të Komisionit, Për votuan tre anëtarë, ndërsa abstenuan Teuta Haxhiu dhe Ismajl Kurteshi.

4. Shqyrtimi i projekt buxhetit për 2017 për MASHT, MKRS dhe Ministrinë e Diasporës;

Nait Hasani lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se arsyeja pse kemi ftuar Ministrin e MASHT është shqyrtimi dhe analizimi i buxhetit, mundësitë për realizimin e tij dhe çështje tjera me interes për këtë ministri.

Arsim Bajrami tha se buxheti i MASHT për 2017 është 45 milion euro duke iu shtuar edhe 11 milion euro huamarrje nga Banka Botërore dhe rreth 25 milion euro tjera donacione nga Bashkimi Evropian, qeveria e Luksemburgut, ajo gjermane dhe qeveri tjera. Ai tha se ky buxhet përfshin gjashtë universitete publike, përfshijë Universitetin e Prishtinës e cila është njësi e pavarur e buxhetit. Poashtu përfshihen katër institute të mëdha, tri agjenci, katër shkolla të kompetencës që janë në varësi të ministrisë si dhe disa qendra burimore. Ministri tha se buxheti është jashtëzakonisht i vogël dhe ky buxhet nuk e arsyeton atë që është paraqitur në planin strategjik që arsimit është prioritet kombëtar. Problemi kryesor është mbijetesa e universiteteve të reja dhe ata nuk po arrijnë të rrisin kapacitetet e tyre. Buxheti përfshin ndërtimin e dhjetë shkollave të reja si dhe njëzet e pesë kopshte, fondet e së cilave janë siguruar nga instrumenti i IPA-së.

Arsim Bajrami shtoi se do të ndërtohen poashtu edhe dy fakultete, ai juridik ose ekonomik si dhe ai i shkencave matematikore-natyrore. Buxheti për to i është dërguar Universitetit. Ai tha se do të bashkëpunojë me Komisionin për Arsim dhe Financa që në leximin e dytë dhe amendamentim të përfshihen disa kërkesa të reja të cilat nuk kanë kaluar në Qeveri. Ministri Bajrami më tej tha se problem kryesor përbën mungesa e mjeteve për komponenten e ngritjes së cilësisë dhe fatkeqësisht kjo komponentë po mbulohet kryesisht me fonde ndërkombëtare. Këtu përfshihen trajnimi i mësimit mësimor si dhe çështja e teksteve. Sipas tij, sivjet pritet të pilotohet projekti për tekstin dixhital. Arsim Bajrami në fund theksoi se ky buxhet siguron mbijetësinë e sistemit arsimor por jo edhe ngritjen e cilësisë së tij.

Shpejtim Bulliqi shprehi shqetësimin e tij për projekt-buxhetin sa i përket fondeve të parapara për laboratorët në Universitetin e Prishtinës, ku janë ndarë 600 mijë euro dhe tha se do të duhej që të specifikohet se për cilat fakultete është paraparë kjo shumë apo si tërësi për të gjitha laboratorët e Universitetit të Prishtinës. Një çështje tjetër ishte ndërtimi i objektit për fakultetin e shkencave matematikore-natyrore. Ai tha se ky fakultet përballet me probleme të mëdha për hapësirë mësimore të cilat pamundësojnë mbarëvajtjen e mësimit, si rrjedhojë e kësaj mësimi praktik mbahet në korridore të bodrumit të fakultetit filologjik. Ai më tej shtojë që ky fakultet do të duhej të përbente prioritetin më të madh për shkak të gjendjes aktuale në të cilën është.

Më tej foli për shpenzimet kapitale prej mbi 50 mijë eurove që janë paraparë për Akademinë e Shkencave dhe tha se do të ishte më mirë që kjo shumë të destinohet për bursa për student të dalluar pasi që Akademia ka objekt të ri dhe nuk paraqet ndonjë nevojë për shpenzime kapitale shtesë. Në vazhdim të diskutimit, ai tha se sa i përket lokacionit për ndërtimin e fakultetit të FSHMN-së, ky fakultet i ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm Komunës së Prishtinës, në vendin ku ishte planifikuar të ndërtohet Fakulteti i Edukimit më parë dhe ai lokacion është i lirë, andaj sipas tij është mirë që në bashkëpunim me Rektoratin të shtyhet përpara ky projekt dhe të ndërtohet objekti për FSHMN-nën.

Ismajl Kurteshi tha se pavarësisht që është folur për ngritjen e cilësisë në arsim, ky buxhet nuk tregon të njejtën pasi që ky buxhet është për 5 milion euro më i vogël sesa ai i vitit 2014 dhe në këtë aspekt ka degradim. Ai theksoi se struktura e ndarjes ka ndryshuar shumë dhe se buxheti për investime kapitale është për 50% më i vogël sesa ai paraprak dhe se duhet të i kushtohet më shumë kujdes dhe vëmendje prioriteteve. Ai shtoi se fakulteti i shkencave matematikore-natyrore nuk ka kushte elementare për punë dhe se nuk ka ndonjë prioritet karshi fakulteteve tjera të cilat pranojnë student përtej kapaciteteve të tyre dhe tani kërkojnë ndërtimin e hapësirave të reja.

Ai përmendi një shqetësim rreth një shkolle fillore në fshatin Haxhaj në Gjilan, shkollë cila është e dëmtuar rëndë dhe rrezikohet të shembet dhe si pasojë mund të marr jetë njerëzish dhe theksoi se Ministria ka qenë e njoftuar për këtë rast por që deri tani nuk ka ndërmarrë asgjë.

Teuta Haxhiu gjithashtu theksoi nevojën urgjente që ka ndërtimi i objektit për fakultetin e FSHMN-së. Ajo ngriti shqetësimin e mungesës së kampusit universitar në komunën e Gjakovës, pavarësisht që komuna ka plotësuar të gjitha kushtet që ka pasur për obligim. Në vazhdim ajo shtoi se është shqetësuese që Qeveria nuk e sheh si prioritet ngritjen e arsimit në Kosovë dhe me një mungesë të tillë të prioritizimit dhe mjeteve për arsim, nuk do të ketë as zhvillim të vendit. Ajo paraqiti edhe nevojën për ndërhyrje në shkollën fillore në fshatin Dermjan, gjendja e së cilës është e rëndë, mungesa e një gjimnazi në fshatin Ponošec ka bërë që klasët e gjimnazit në Gjakovë të jenë të mbingarkuara, kështu që ndërtimi i këtij gjimnazi në këtë fshat do të u ndihmonte pa masë familjeve dhe fëmijeve të tyre në veçanti. Ajo shtoi që vazhdimisht do të kërkojë rritje të buxhetit për Ministrinë e Arsimit sepse nuk do të ketë cilësi në arsim pa buxhet. Një shqetësim tjetër ishte edhe çështja e llogaridhënies për milionat e shpenzuara për trajnimin e mësimitdhënësve.

Bekim Haxhiu shprehi interesimin që të dijë se sa është buxheti i ndarë për shkencë dhe a është kompatibil më ligjin për veprimtari dhe kërkime shkencore.

Salih Morina propozoi që aty ku është e mundshme të harmonizohen projektet me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që kanë qëllimin e njejtë siç janë sallat e sportit dhe në këtë mënyrë të evitohet ngarkesa buxhetore e ndonjëri ministri dhe në këtë mënyrë ato mjete të barten për projekte tjera.

Mufera Sinik pyeti ministrin se si ka planifikuar ministria që të sigurojë materialet didaktike, hartat, fletore pune, etj për gjuhën turke.

Në mungesë të përfaqësuesve të Ministrisë së MKRS-së dhe Diasporës, debati për projekt-buxhetin për këto dy ministri nuk u zhvillua.

5. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani